



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 15, datë 27.02.2019

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“NDËRTIMI I RESORTIT TURISTIK "NEW BORN",
BASHKIA SUKTH, QARKU DURRËS”

Në mbështetje të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “ALENTRE” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Ndërtimi i Resortit Turistik “New Born”, miratuar me *Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.10, datë 10.05.2013 “Leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e resortit turistik “New Born”, Bashkia Sukth, Qarku Durrës”, i ndryshuar, vetëm për pjesën e projektit që po zbatohet nga subjekti zhvillues shoqëria “ALENTRE” sh.p.k.*
2. Fragmenti i Hartës së Planvendosjes së Strukturave, miratuar me *Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.10, datë 10.05.2013 “Leje zhvillimore komplekse për ndërtimin e resortit turistik “New Born”, Bashkia Sukth, Qarku Durrës”, i ndryshuar, për pjesën e projektit që po zbatohet nga subjekti zhvillues shoqëria “ALENTRE” sh.p.k, zëvendësohet me fragmentin e Hartës së Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij vendimi.*
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMITË TERRITORIT

LEDIA TOJA

